



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/15

Datë: 25.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2015–2018.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit për përfshirjen e qëndrimeve të Qeverisë në tekstin e Programit nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin nga pika 1. e këtij Vendimi t'ia procedojë për njoftim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/15

Datë: 25.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 16 paragrafi 2. të Ligjit për Partneritet Publiko Privat nr. 04/L-045, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komiteti për Partneritet Publiko Privat, në këtë përbërje të anëtarëve të përhershëm:
 - 1.1. Ministri i Financave, Kryesues;
 - 1.2. Ministri i Zhvillimit Ekonomik;
 - 1.3. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;
 - 1.4. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
 - 1.5. Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor.
2. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë nr. 02/56 i datës 11.01.2012 për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Partneritet Publiko Privat.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/15

Datë: 25.02.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 13 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 03/L-190 për Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (GZ Nr.74/2010 dt. 20 korrik 2010), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 shkurt 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Subjektet përfituese që do të marrin falas ekzemplarët e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës, caktohen:
 - 1.1. Institucionet arkivore të Kosovës të nivelit qendror dhe lokal;
 - 1.2. Bibliotekat publike (universitare, komunale, arsimit të mesëm dhe fillor).
2. Subjekteve përfituese sipas pikës 1. të këtij Vendimi do t'u shpërndahen ekzemplarët e mbetur të Gazetës Zyrtare të botuara në formë të librit nga vitit 2012 e deri në vitin 2015.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë